PROCESVERBAL

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 19.12.2022, e hënë me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve dhe të kryetarit të komunës z. Blerim Sejdiu.

Seancën e 13-të(trembëdhjetë) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Bafitjari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-1692/1.

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së 12-të(dymbëdhjetë) të Këshillit të komunës së Zhelinës.
2. Propozimi- Program për punën e këshillit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të
3. Propozim – Program për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të
4. Propozim-Program për përpunimin e planeve (PU), në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të
5. Propozim- Program për përpunimin e projekteve urbanistike në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të
6. Propozim- Program për vendosjen e paisjes urbane në territorin e komunës së Zhelinës.
7. Propozim- Program për disponim me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
8. Propozim-Program për begatonizimin e rrugëve në vendbanimet e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të
9. Propozim- Program për ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve lokale në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të.
10. Propozim- Program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
11. Propozim- Program për mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrjetit të rrugëve lokale në territorin e komunës së Zhelinës, për periudhën dimërore dhe verore 2022/2023-të
12. Propozim- Program për të mbrojtur shëndetin e popullatës në zonën e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
13. Propozimi- Program për aktivitetet e komunës së Zhelinës në sferën e mbrojtjes sociale për vitin 2023-të.
14. Propozim- Program për aktivitetet e komunës së Zhelinës në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, mbrojtjes kundër zjarreve dhe menaxhimin me krizat në vitin 2023-të
15. Propozim- Program për masë për strehim të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
16. Propozim- Plani Akcional për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave 2023/24-të.
17. Propozim- Program për aktivitetet nga sfera e mundësive të barabarta mes grave dhe burrave në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të
18. Propozim- Program për aktivitetet sportive dhe kulturore në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të
19. Propozim- Program për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, aktiviteteve shkollore dhe jashta mësimore në shkollat fillore të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të
20. Propozim- Program për mjediset e gjelbërta në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të
21. Propozim- Program për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndriçimit publik si dhe ndërrimin e poçave elektrik në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të
22. Shqyrtimi i kërkesave.

Pas prezantimit të pikave, kryetari i këshillit Bujar Baftjari hapi diskutim.

Fjalën e mori këshilltari Naser, kërkoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë, dhe të jetë e dyta në radhën e redit të ditës dhr atë diskutim rreth mënyrës së pagesës së këshilltarëve.

Pas këshilltarit Naser, fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Me që rendi i ditës ka të bëjë me Propzim –Programe që përfshin vitin 2023, para se të kalohet në diskutim dhe hudhje në miratim të pikave të rendit të ditës, do të kisha dashtë që paraprakisht ata që janë kompetent sqarime për programet dhe të na japin raport për realizimet e programeve për vitin 2022. Ne si këshilltarë dhe si qytetar duam të dimë se cka u miratua nga këto programa e cka u realizau dhe e kundërta.

Këshilltarit Sheval sqarime i dha Udhëheqësja e njësis për punë normativo-juridike Shefije Saiti.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjaripropozimin e këshilltarit Naser : " Diskutim rreth mënyrës së pagesës së këshilltarëve" e hodhi në votim, me 9 vota për dhe 8 të përmbajtur kjo oikë kaloi.

Kryetari i këshillit e deklaroi se rendi i ditës përbëhet nga 23 pika, dhe e hodhi në votim rendin e ditës. Unanimisht u votua dhe pas kësaj e shpalli të hapur seancën e 13.

1. Pikën e parë të rendit të ditës "Miratimi i procesverbalit të seancës së 12-të(dymbëdhjetë) të Këshillit të komunës së Zhelinës". Kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht.
2. Për pikën e dytëDiskutim rreth mënyrës së pagesës së këshilltarëve" , kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori Sheval S.

Sheval S: Kjo cështje ka qenë diskutabile edhe në mandatin e parë të këshilltarëve. Ne kërkojmë që të zbatohet rregulla ligjore e shkruar që pararsheh mënyrën e kompenzimit të këshilltarëve komunal. Këtë e kemi biseduar edhe me përfaqsuesin e administratës z. Adil Eminin në prezencë të kryetarit të komunës z. Blerim Sejdiu. Ligji për kompenzim dhe paga parasheh që këshilltarët të paguhen konkretisht në komunën e Zhelinës 60 % nga paga NETO për vitin paraprak, ndërsa me pagesën e fundit që na është bërë për 11 muaj seanca që kemi pas, ne kemi marrë një pagesë edhe ajo është bërë me mesataren Neto të vitit 2020 edhe atyë me 50%, ndërsa pagesa në bazë të ligjit për komunën e Zhelinës është 60%. Këtë kisha si dilem ta ngre si debat, mirëpo me qenë se në materialin e propozuar nga administrata komunale që e kemi pikë të shqyrtimit sot në këtë seancë të këshillit konkrtisht në planin akcional për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave,thotë : komuna e Zhelinës gjendet në pjesën perndimore të RMV-së , përfshin hapësirë prej 199km2 dhe sipas të dhënave të vitit 2021 jetojnë 28 382 banorë. Pagesa e këshilltarve duhet të bëhët me 60% të rrogës Neto, lutem që kjo të merret seriozisht.

Adil Emini i dha sqarimet pëer këtë cështje.

Pas Adilit, Kryetari i Komunës Blerim S tha:Prej krize ende nuk kemi kaluar besoj se krejt shteti është në krizë. Për së pari herë në RMV ndodh që popullata klasifikohet në rezident jo rezident dhe administrator. Do të ndalem te pjesa e aspektit financiar, ne kemi qenë disa herë edhe për takime me komuna tjera me institucione ka qenë edhe Adili e kemi diskutu edhe me komunat e tjera edhe me ZELLS-in, dhe me Ministrinë e Financave .

Kumuna e Zhelinës ka pas përafërsisht 30 mijë banorë apo me regjistrimin e vitit 2002 ka pas 28 mijë banorë dhe mjetet financiare janë ndarë në bazë të nr të përgjithshëm të popullsisë. Tani me regjistrimet e reja komuna e Zhelinës rezident ka 19 mijë banorë dhe pjesa tjetër janë jo rezident. Ministria e Financave respektivisht qeveria mjetet që na lëshon neve na lëshon në bazë të rezidentëve , dhe ne tash marrim mjete sa për 19 mijë banorë.

Bujar B: Mendoj se është e qartë ekziston ligji dhe veprohet në bazë të tij.

Sheval S: Ligji është i qartë por nga interpretimi si bëhet unë nuk kuptoj aspak. Nëse duhet të ulet, ne me 50% i kemi marrë pagesat, mirëpo sa është e drejtë të paguhemi mbi bazë të mesatares nuk e di.

Pasi mbaruan sqarimet kryetari i këshillit kaloi te pika e tretë.

3. Propozimi- Program për punën e këshillit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të

Pika u hodh në votim, me 11 vota për dhe 5 të përmbajtur kaloi.

4. Propozim – Program për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të, u hodh në votim ku me 10 vota për dhe 6 të përmbajtur, kaloi.
5. Propozim-Program për përpunimin e planeve (PU), në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të, u hodh në votim me 10 vota për dhe 6 të përmbajtur kaloi.
6. Propozim- Program për përpunimin e projekteve urbanistike në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të, u hodh në votim me 10 vota për dhe 6 të përmbajtur kaloi.
7. Propozim- Program për vendosjen e paisjes urbane në territorin e komunës së Zhelinës, u hodh në votim me 12 vota për dhe 4 të përmbajtur kaloi.
8. Propozim- Program për disponim me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të, u hodh në votim ku me 10 vota për dhe 6 të përmbajtur kaloi.
9. Propozim-Program për begatonizimin e rrugëve në vendbanimet e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Fjalën e mori këshilltari Naser: Te kjo pikë memdoj se 1000m2 janë pak, të shtohen së paku edhe 1000 m2. Këtë propozim të këshilltarit Naser bashkë me oikën e rendit të ditës, kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht.

10. Propozim- Program për ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve lokale në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të. U hodh në votim ku me 13 vota për dhe 4 të përmbajtur kaloi.
11. Propozim- Program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të. U votua unanimisht.
12. Propozim- Program për mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrjetit të rrugëve lokale në territorin e komunës së Zhelinës, për periudhën dimërore dhe verore 2022/2023-të

Hapi diskutim. Fjalën e mori Sheval S.

Sheval S: Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve unë si këshilltar propzoi që kjo mirëmbajtje t'i takoj ndërmarrjes komunale, se mendoj se shpallja e ankandit nga ana e komunës është i panevojshëm. Pra kështu kursehet edhe komuna.

Fjalën e mori kryetari i komunës z. Blerim Sejdiu, dhe dha saqrimet e duhura me pak fjalë sqaroi që ligji nuk e lejon këtë që propozoi këshilltari Sheval.

Sheval S: Nuk mund ta pranojë që ligji nuk e lejon që mirëmbajtja e rrugëve t'i kaloj ndërmarrjes, e kur bëhet fjalë për pagesa për financa themi se komuna ka krizë. Unë mendoj që përderisa komuna ka të drejtë të themeloj ndërmarrjen, mendoj se ka të drejtë edhe t'i mbarti kompetencat. Ajo se a do ja del ndrëmarrja komunale është diçka tjetër.

Adil E: Për ndërmarrjen kjo do të ishte ngarkesë sepse edhe edhe ndërmarrja do të hapte tender se nuk ka kapacitet, pra nëse ja lëmë ndërmarrjes e dëmtojm.

Sheval S: Unë e di gjendjen e ndrëmarrjes, nuk mirëmbahen 18 vendbanime me një eskavator. Qëllimi është që ndërmarrja të furnizohet, të mbështetet që në të ardhmen kjo kompetencë t'i shtohet ndërmarrjes.

Pas sqarimeve, kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

13. Propozim- Program për të mbrojtur shëndetin e popullatës në zonën e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi dikutim. Fjalën e mori këshilltari Ajredin Sadiki.

Ajredin S: Sai përketë kësaj pike mendoj se vitin e kaluar komuna e Zhelinës nuk është interesuar për shëndetin e popullatës, propozoj si ide të formohet një komision që t'i mbroj të drejtat e pacienteve.

Bujar B: Është Ministria e Shëndetësisë që merret me këto punë, nuk ka komuna kompetenca.

Kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

14. Propozim- Program për aktivitetet e komunës së Zhelinës në sferën e mbrojtjes sociale për vitin 2023-të.

Pasi nuk kishte diskutim, kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

15. Propozim- Program për aktivitetet e komunës së Zhelinës në fushën e mbrojtjes kundër zjarreve dhe menaxhimin me krizat në vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori këshiltari Naser M.

Naser M: Dëgjova para disa ditësh se në fshatin Pallaricë ka pas përmbytje. Sa ka ndërhyrë komuna.

Shaban Limani nga seksioni për urbanizëm dhe mbrojtje të ambientit jetësor dha përgjigje se është paraqitur si rast, është dërguar kërkesa dhe ato kërkesa pritet që të kalojnë në këshill.

Këtë pikë kryetari i këshillit e hodhi në votim, dhe u votua unanimisht.

16 . Propozim-Program për masë për strehim të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kjo pikë u votua unanimisht.

17. Propozim- Program Akcional për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave 2023/2024-të.

Kjo pikë u votua unanimisht.

18. Propozim-Program për aktivitetet nga sfera e mundësive të barabarta mes grave dhe burrave në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të.

Dhe kjo pikë u votua unanimisht.

19. Propozim- Program për aktivitetet sportive dhe kulturore në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të.

Për këtë pikë fjalën e mori këshilltari Naser M.

Naser M: Është vendosur një pikë për klubet futbollistike me që vitin që lamë pas e votuam të njëjtën, dua nga administrata kush është përgjegjës të jap sqarime a ka marr ndonjë klub financa nga komuna apo s'ka marr?

Përgjegjësi nga administrata Sabri Nafiu i dha sqarimet e duhura.

Kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

20. Propozim- Program për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, aktivitetet shkollore dhe jashta mësimore në shkollat fillore të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Sheval S.

Sheval S: Sa i përket kësaj pike që ka të bëj me shkollat unë si këshilltar propzoi që t'i shtohet edhe rrethimi i fushës së sportit ose dy shtylla të basketit.

Kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

21. Propozim- Program për mjediset e gjelbërta në komunën e Zhelinës për vitin 2023-të.

Kjo pikë u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

22. Propozim- Program për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndriçimit publik si dhe ndërrimin e poçave elektrike në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kjo pikë u hodh në votim dhe me 13 vota për dhe 5 të përmbajtur, kaloi.

23. Shqyrtimi i kërkesave.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjari tha: Kemi dy kërkesa. Kërkesa e parë është e shkollës fillore komunale "Pashko Vasa" Grupçin drejtuar deri te kryetari i komunës së Zhelinës dhe këshillit të komunës. Kjo shkollë e fshatit Grupçin kërkon nga titulli i lartë shënuar që të mundësoj pëlqim për tokën dhënie me qira të ish ambulantës e cila është pronë e shkollës me ekstrakt nga plani kadastral 14 92. Kërkesa është arkivuar me nr. 081599/1 me 25.11.2022.

Kryetari i këshillit hapi diskutim.

Fjalën e mori këshilltari Naser M.

Naser M: Është diçka e dyshimtë nuk e kuptoj.

Kryetari i komunës z. Blerim Sejdiu dha sqarimet e detajuar për këtë pikë. Pastaj u hodh në votim ku u votua unanimisht.

Kryetari i këshillit vijoi me kërkesën e dytë. Kjo kërkesë vinë nga Shoqata e personave të verbër, ka parashtruar kërkes deri te Kryetari i Komunës me nr. 051616/1 me 30.11.2022. Kërkojnë mjete financiare për realizimin e një pjese të aktiviteteve të parapara në programin vjetor të tyre në vlerë prej 15 000 den.

Kjo kërkesë u hodh në votim, ku me 4 vota pro, 14 të përmbajtur nuk kaloi.

Kryetari i komunës z. Blerim Sejdiu i falënderoj këshilltarët dhe tregoi se për vitin e ardhshëm çështja e pagesave të këshilltarëve është zgjidhur.

Më pas kryetari i këshillit Bujar Baftjari e shpalli të mbyllur seancën e 13(trembëdhjetë).

Nr.08-1692/2
19.12.2022-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari